



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:000962
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05294534

KE.nr. 425/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve “Gizzi Grill” Sh.P.K., me nr. të biznesit 810168030 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate T.Zh. nga Prishtina, kundër të paditurës Gazeta Sinjali me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi për shkak të shpifjes dhe fyerjes, jashtë seancës, me datë 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike kontestimore në mes të paditësit “Gizzi Grill” Sh.P.K., kundër të paditurës Gazeta Sinjali me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi për shkak të shpifjes dhe fyerjes.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi “Gizzi Grill” Sh.P.K., me datë 04.01.2023 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, kundër të paditurës Gazeta Sinjali me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi për shkak të shpifjes dhe fyerjes.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas pranimit të padisë, me aktvendimin C.nr. 23/23 të datës 27.01.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, ashtu që lëndën e ka dërguar për Gjykatën Komerciale të Kosovës.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*,

Referuar dispozitave të lartcekura, Gjykata vlerëson se çështjet që kanë të bëjnë me shpifje dhe fyerje, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkak se shpifja dhe fyerja, nuk hyn në kuadër të çështjeve të ndërsjella tregtare dhe as çështjeve tjera që ndërliken me raportet afariste në mes tyre.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 425/23, datë 07.02.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.